



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 901 Prot.

Tiranë, më 14.06.2021

Lënda: Dërgohen komente lidhur me “*Draft Matricën Antixhipsizm të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025*”.

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Adresa: Rruga e Kavajës, Tiranë

TIRANË

Në vijim të kërkesës Tuaj, të përcjell nëpërmjet e-mailit me lëndë: “*Kërkohen komente lidhur me draft Matricën Antixhipsizm*” dhe në vijim të takimit *on-line* të datës 17 Maj 2021, të organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi u konsultua me dokumentin, ju parashtron disa komente si më poshtë:

Paraprakisht, kemi konstatuar se në këtë matricë, pjesë e *Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025*, institucionit të Komisionerit i janë lënë në përgjegjësi shumë aktiviteteve me rolin si institucion përgjegjës. Duke mbajtur parasysh misionin që ka Komisioneri, si një institucion i pavarur që garanton zbatimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, Komisioneri duhet të nxitet në këtë matricë të ketë rol monitorues dhe jo zbatues.

Gjithashtu, në kuadër të pavarësisë së Institucionit, çdo kosto shtesë dhe çdo shpenzim që parashikohet për implementimin e këtij plani, nuk duhet të rëndojnë në institucionet e pavarura, që për më tepër janë institucione buxhetore.

Objektivi nr. 1 “Njohja dhe përfshirja e Antixhipsizmit në politikat publike”, aktiviteti me emërtimin “*Operacionalizimi i termit Antixhipsizm dhe përfshirja e tij edhe në dokumente të tjerë politikë, ligje etj*”.

Në këtë aktivitet, institucion përgjegjës është përcaktuar të jetë Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS). Lidhur me sa është parashikuar, propozojmë që Komisioneri, në këtë aktivitet të ketë rol monitorues dhe mbështetës dhe jo të jetë institucion përgjegjës për zbatim, për arsye se, Komisioneri, nuk është institucion politikë-bërës apo me iniciative ligjore. Përgjegjësinë për këtë aktivitet besojmë se mund ta ndërmarrin të gjitha Ministrinë e Linjës të cilët hartojnë politika. Në bazë të Ligjit 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri, ndër të tjera është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të këtij Ligji.

Aktiviteti 1.3, në po këtë objektiv përcakton: “*Ngritja e grupeve të punës me ekspertë (përfaqësuese të administratës si dhe ekspertë të pavarur) që punojnë për Antixhopsizmin dhe zhvillojnë propozime dhe rekomandime për politikëbërësit/politikëbërjen në fusha të ndryshme*”, ku institucion përgjegjës është përcaktuar Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Sikurse u theksua, edhe gjatë takimit *online* të datës 17 maj 2021, nga përfaqësues të Komisionerit, i qëndrojmë mendimit se, përsa kohë kjo matricë është pjesë e Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025, ngritja e grupeve të punës bëhet në bazë të një Urdhri nga institucionet përgjegjëse për mbrojtjen shoqërore. Pra, ngritja e grupeve të punës nuk mund të jetë nën përgjegjësinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Komisioneri, shpreh dakortësinë që të jetë pjesë e grupit të punës duke dhënë ekspertizën e tij.

Aktiviteti 1.6: “*Analizimi i ligjeve dhe politikave ekzistuese që janë më relevante për R&E për identifikim të diskriminimeve direkte dhe indirekte (apo të fshehta) që mund të ndikojnë negativisht në jetët e R&E*”.

Lidhur me analizimin dhe identifikimin e legjislacionit për identifikim të diskriminimeve direkte dhe indirekte, Komisioneri për mbrojtjen nga Diskriminimi mund të jetë institucion përgjegjës. Si tregues i përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është edhe “*Numri i ligjeve të ndryshuar*”. Sjellim në vëmendje se Komisioneri, mund të rekomandojë përmirësim legjislacioni ose të praktikave diskriminuese, por mbajtja parasyshe e këtyre rekomandimeve nuk mund të jete përgjegjësi e Komisionerit, pasi nuk ka iniciative ligjvënëse dhe ndryshimet ligjore nuk janë në vullnet të këtij institucioni, sikundër rezultojnë në shumë raste rekomandimet për përmirësimin e legjislacionit, jo gjithmonë janë marrë në konsideratë nga institucionet e tjera. Institucione përgjegjëse në këto aktivitet janë vendosur dy organe të pavarura që nuk kanë kompetenca për të realizuar ndryshime ligjore, por vetëm bëjnë rekomandime. Rekomandohet që roli i organeve të pavarura të jetë mbështetës, monitorues dhe jo përgjegjës.

Objektivi 2: “*Rritja e ndërgjegjësimit për R&E si dhe publikun e gjerë për të drejtat e tyre, si pjesë integrale e shoqërisë Shqiptare*”, aktiviteti 2.5 “*Fushata ndërgjegjësimi për të drejtat e njeriut në/me komunitetet R&E*”, ku një ndër institucionet përgjegjëse për këtë aktivitet është i përcaktuar Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Lidhur me këtë aktivitet theksojmë se Komisioneri, ka në kompetencë të tij zhvillimin e aktiviteteve të ndërgjegjësimit dhe edukimit, të cilat ndihmojnë në zbatimin e Ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar. Ndërgjegjësimi realizohet në disa forma, siç janë prezenca dhe intervistat e Komisionerit në media, takimet me komunitetin dhe grupe të ndryshme, shpërndarja e botimeve të KMD-s etj. Komisioneri ndërgjegjëson edhe nëpërmjet bashkëpunimit me organizatat jofitimprurëse, në zbatim të projekteve të ndryshme. Në këtë aktivitet të parashikuar, nuk është e qartë si do të bëhet mbështetja financiare për aktivitetet e nevojshme. Në rast se mbulimi financiar është propozuar që të mbulohet nga vetë Komisioneri, atëherë do të propozonim që treguesit, përsa i përket Komisionerit, të jetë vetem “numri i aktiviteteve” të ndërmarra (aktivitete në kuptim të atyre që KMD-realizon gjatë veprimtarisë së tij, pa kosto shtesë).

Objektivi 3: “Ulja e diskriminimit ndaj R&E dhe përmirësimi i aksesit në drejtësi për barazë”, aktiviteti nr. 3.1 “Rekomandime përmirësimin dhe përafrimin e kuadrit ligjor kombëtar me atë të BE-së, me ndjeshmëri nga çështjet R&E”.

Lidhur me këtë aktivitet, Komisioneri shprehet se dhënia e rekomandimeve me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor kombëtar, në përputhje me standartet evropiane dhe ndërkombëtare, është kompetencë të cilën Komisioneri e ushtron në vazhdimësi. Përsa i përket përafrimit të legjislacionit dhe marrja përsipër e nismave konkrete për ndryshime ligjore nuk është kompetencë e Komisionerit. Pra, mund të jetë Komisioneri përgjegjës për dhënien e rekomandimeve me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor me fokus mbrojtjen nga diskriminimi, por përafrimi i kuadrit ligjor dhe treguesi “numri i ndryshimeve të realizuara” nuk mund ti ngarkohen KMD-së, pasi nuk gëzon iniciativë ligjore.

Lidhur me aktivitetin “3.2 Ndërmarrja e proceseve gjyqësore me interes publik, aksioneve pozitive etj në luftën kundër diskriminimit të R&E.”, mendojmë se treguesi i cili mund të vendoset për matshmërinë e aktivitetit është: “Rasti anti-diskriminim i dërguara para gjykatës për interes publik”. Dy treguesit e tjerë të përcaktuar në draft-matricë nuk janë të lidhura me këtë aktivitet.

Lidhur me aktivitetin 3.3 “Monitorimi i rasteve të diskriminimit ndaj R&E për identifikimin e fushave me incidencë më të lartë dhe barrierave për të marrë drejtësi”, ku KMD është përcaktuar institucion përgjegjës, propozojmë të bëhet një reformulim, duke e përcaktuar si: “Raportimi i rasteve të ndjekura ndaj R&E, nga KMD dhe identifikimin e fushave me incidencë më të lartë.”

Objektivi 4: “Minimizimi/eliminimi i gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes ndaj R&E” aktivitetin 4.2 “Monitorimi sistematik i gjuhës antixhipsiste dhe krimeve të urrejtjes: mbledhja e të dhënave dhe raportimi mbi gjuhën e urrejtjes ndaj R&E.”

Sikurse e theksuam edhe gjatë takimit online, Komisioneri ka në vëmendje të veçantë çështjet e “gjuhës së urrejtjes” dhe pasqyron të dhënat që ai disponon lidhur me këtë formë

diskriminimi, e cila në pjesën më të madhe reflektohet me vendimet, rekomandimet dhe nisjen e çështjeve *ex officio*. Monitorimi sistematik i “gjuhës së urrejtjes” kërkon staf shtesë dhe të dedikuar që të mund të realizohet në sasi dhe cilësi. Komisioneri, nuk disponon kapacitete për ta realizuar këtë objektiv në mënyrë sistematike dhe periodike. Kryerja e këtij monitorimi kërkon bashkëpunimin e shumë institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile.


Përsa i përket “krimit të urrejtjes”, nuk është në fushëveprimin e Komisionerit mbledhja e statistikave lidhur me këtë vepër penale, por e organeve të Policisë dhe Prokurorisë.

Në Aktivitetin 5.4 “Mbështetje e SHC R&E me aktivitete për ndërtim kapacitetesh dhe promovim të minoriteteve R&E”, Komisioneri është përcaktuar institucion përgjegjës. Lidhur me këtë angazhim të përcaktuar, theksojmë se bazuar në Ligjin 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri ka në kompetencë të tij mbështetjen e shoqërisë civile për ndërtim dhe forcim kapacitetesh, sidomos në njohuri dhe praktikë ligjore dhe gjithashtu ai kryen aktivitete të ndryshme për promovimin e pakicave Rome dhe Egjiptiane. Gjithësesi, përcaktimi i tij si institucion përgjegjës në lidhje me këtë aktivitet e ngarkon institucionin në mënyrë të paqartë dhe me përgjegjësi shtesë duke e fokusuar atë në lidhje vetëm me njërin nga shkaqet e mbrojtura nga Ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndërkohë që ky Ligj kërkon impenjimin e Komisionerit për mbrojtjen e të gjitha grupeve vulnerabël të diskriminuara në Shqipëri.

Në përfundim, Komisioneri vëren se i është atribuar një rol i shtuar në disa aspekte, për të cilat në pjesën më të madhe nuk ka kompetencë ligjore, burime njerzore e materiale, për ti realizuar. Komisioneri e përshëndet, rëndësinë që organet publike i japin në përfshirjen në Planet e Veprimit, por kjo duhet bërë në përputhje me Ligjin dhe duke parashikuar burime financiare dhe njerzore, për realizimin e veprimeve shtesë që i kërkojnë brenda kompetencave të tij, pasi në të kundërt çënohet cilësia e veprimitarisë dhe pavarësia e institucionit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI


ROBERT GAJDA